



Datë: 07.05.2026

A.nr. 184/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.184/2026, të datës 19.02.2026, të parashtruar nga ankuesi Z.H, të cilin ma autorizim e përfaqëson Avokati H.S, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 07.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.184/2026, e datës 19.02.2026, e parashtruar nga ankuesi Z.H.
- II. Anulohet** Vendimi Nr.01/2026 i datës 04.02.2026 i nxjerrë nga Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor.
- III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme juridike me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil Z.H (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 19.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me numër:882/2026, kundër Vendimit Nr.01/2026 të datës 04.02.2026 të Ushtresit të Detyrës të Drejtorit të DSISH, përmes të cilit akt ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit më datë 26.02.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit, me datë 02.04.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:1660/2026, përmes të cilit ankuesës së ankuesit nën shenjë A.nr.184/2026 të datës 19.02.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 882/2026 të datës 19.02.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës, të datës 19.02.2026; Vendimin Nr.01/2026 të datës 04.02.2026 të Ushtresit të Detyrës të Drejtorit të DSISH; E-mailin e datës 04.02.2026 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e MSH-së; Raportin dy (2) mujor; Vendimin e datës 26.11.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm; Autorizimin e datës 18.02.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.02.2026; Përgjigje në kërkesë e datës 26.02.2026; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 02.04.2026; Akt Emërimit e ankuesit të datës 21.01.2026; Vendimin e datës 26.11.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSh-së; Vendimin e datës 13.08.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSh-së.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga shqyrtimi i provave të administruara, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi me datë 26.11.2025 me Vendimin Nr.867/XI/2025 ishte kthyer në vendin e tij të punës, në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Planifikim Strategjik të SISH*, në kuadër të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe po të njëjtit i ishte lëshuar edhe Akti i Emërimit me datë 21.01.2026, për pozitën përkatëse.

Ankuesi, përmes emailit të datës 30.01.2026 kishte paraqitur Raport dy mujor për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe kabinetin e Ministrit ndërsa për raportimin në fjalë e kishte mbajtur të njoftuar edhe udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë, respektivisht Ushtruesin e Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, ndërsa ky i fundit, respektivisht Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, me datë 04.02.2026 përmes Vendimit Nr.01/2026 ankuesit i kishte shqiptuar masën disiplinore “vërejtje me shkrim” lidhur me raportimin në fjalë të datës 30.01.2026, me arsyetimin se ankuesi ka bërë pasqyrim të pasaktë të gjendjes faktike, dhe ka atribuuar përgjegjësi të pabazuara duke e vënë në lajthitje organin publik.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundër Vendimit Nr.01/2026 të datës 04.02.2026, pretendon se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore janë zbatuar gabimisht dispozitat e aplikuara nga neni 58 paragrafi 2, neni 56 paragrafi 3, neni 57 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe si rrjedhojë akti i kontestuar është i kundërligjshëm sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk është organ kompetent që përcakton nëse një shkelje disiplinore është shkelje e rëndë, pasi që këtë kompetencë e ka komisioni përkatës disiplinor sikurse arsyetimi i dhënë nuk pasqyron konstatimin e saktë të gjendjes faktike pasi që raporti në fjalë ka qenë i karakterit njoftues, si dhe pretendimin që udhëheqësi ia ka pamundësuar ushtrimin e funksionit duke mos e vlerësuar si pjesë të ekipës, me kërkesën që këshilli të aprovoi ankesën e tij si të bazuar ndërsa aktin e kontestuar ta anuloi si të paligjshëm për arsyet e dhëna si më lartë.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, analizoi përmbajtjen e vendimit të datës 04.02.2026 të Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, dhe konstatoi se ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “vërejtje me shkrim” e cila në kuptim të nenit 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 56 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të të njëjtit ligj, përcaktohet se masa e shqiptuar është masë e lehtë disiplinor, kurse Kolegji i Këshillit thekson faktin se në kuptim të nenit 56 paragrafi 3 të të njëjtit ligj përcaktohet se shkelje të lehta disiplinore konsiderohen “mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun”

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit po ashtu konstatoi se në arsyetimin e aktit të kontestuar, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, respektivisht Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, ndër tjerash në arsyetimin e masës së shqiptuar, ka përcaktuar se, **citoj**: “... Megjithatë, edhe pse këto shkelje të rënda disiplinore, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit, përfshirë faktin se i njëjti ka qenë më herët subjekt i procedurës disiplinore dhe ka qenë i suspenduar për një periudhë gati njëvjeçare, si dhe me qëllim të dhënies së një mundësie për reflektim dhe përmirësim të sjelljes profesionale, vlerësohet se shqiptimi i masës disiplinore “vërejtje me shkrim” është masë e drejtë, proporcionale dhe në përputhje me parimin e shkallëzimit të masave disiplinore”.

Duke marrë parasysh konstatimet e dhëna si më lartë, Kolegji i Këshillit theksoi faktin se në mbështetje të dispozitave të aplikuara nga neni 58 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ. 2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni

disiplinor”, ndërlidhur me nenin 59 i të njëjti ligj, si dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, organi kompetentë për përcaktimin nëse një shkelje disiplinore mund të konstatohet apo përcaktohet si shkelje rëndë disiplinore është Komisioni Disiplinor, gjegjësisht përveç përcaktimit nëse një shkelje është e rëndë i njëjti është kompetentë edhe për shqiptimin e masës së rëndë disiplinore, prandaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar, ngase udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit nuk është organi kompetentë dhe as nuk ka autorizimet ligjore të arrij në konstatimin e përcaktimit se cilat shkelje paraqesin shkelje të rënda disiplinore dhe përveç tjerash në emër të shkeljes së rëndë disiplinore, t’i shqiptojë masë të lehtë disiplinore sikurse ka vepruar në rrethanat e rastit konkret përmes aktit të konstatuar ndaj ankuesit, respektivisht vendimit të datës 04.02.2026.

Përveç tjerash, nga administrimi shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, gjegjësisht Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, është caktuar ushtrues detyrë përmes Vendimit të datës 13.08.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, e që sipas pikës I të dispozitivit të këtij vendimi përcaktohet qartë se zyrtari që mban pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, z.A.A, ka pozitën aktuale të punës Zyrtar i lartë i TI-së për Bazën e të Dhënave, ndërsa sipas nenit 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përcaktohet se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit*”, si dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari.*

Andaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimin si më sipër, duke i’u referuar dispozitave të aplikueshme ligjore që rregullojnë caktimin e ushtruesve të detyrës sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ushtruesi i detyrës caktohet zyrtarja/i më i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, kurse në rrethanat e rastit konkret Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, si pozitë më e ulët apo vartëse nuk ka qenë duke e mbajtur me akt të konfirmuar, gjegjësisht i njëjti mban pozitën e kategorisë Profesionale, pozitë kjo e cila nuk është pozitë pasuese e Kategorisë së Mesme Drejtuese, sikurse e ka përcaktuar një gjë të tillë ligji material, nga rrjedh se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka qenë i caktuar ushtrues detyrë i Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit në kundërshtim me ligjin material, respektivisht nenin 35 paragrafi të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Prandaj nga se u tha si më lartë ankesa e ankuesit është aprovuar vetëm mbi bazën e konstatimeve të dhëna si më lartë, për shkak të shkeljeve të ligjit material nga Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, si dhe duke marrë parasysh edhe faktin se ushtruesi detyrës në Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor ka qenë i emëruar në kundërshtim me ligjin, nga rrjedh se mbi këtë bazë është anuluar edhe akti i kontestuar, respektivisht Vendimi i datës 04.02.2026 është anuluar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa Kolegji i Këshillit theksoi fakti se për shkak të shkeljeve të pasqyruara si më lartë, nuk ka mundur të legjitimoi një proces të tillë, ndërsa nuk ka mundur të lëshohet në shqyrtim meritor nëse veprimet e ankuesit me rastin e dërgimit të raportit të datës 31.01.2026, përbëjnë shkelje disiplinore apo jo, pasi që ligji material ka përcaktuar qartë autorizimet ligjore në kuadër të organit të punësimit, se kush janë zyrtarët respektivisht mekanizmat apo organi kompetentë për konstatimin e llojeve të shkeljeve disiplinore si dhe shqiptimin e masave përkatëse.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore, duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare, ashtu që në rast se ankuesit i është ekzekutuar masa e shqiptuar disiplinore, të njëjtën duhet ta largojë nga dosja personale e tij, kurse Sekretari i Përgjithshëm duhet të kujdeset që caktimi i ushtruesve të detyrës për pozitë përkatëse të kategorisë drejtues, duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material të pasqyruara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Theksuar si më lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda;A.nr.184/2026, datë 07/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokat H.S;
- Ministrisë së Shëndetësisë (Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore), dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.